

A K T I T H E M E L U E S

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "A L S T E Z O"

E lidhur sot me daten 16 Korrik te vitit 1995 ne Fier ndermjet personave te pranushem si me poshte:

- 1- Albert Zogaj ,shtetas shqipetar i dt 1963 lindur dhe banues ne Fier ne adresen "Lagja 16 Prilli"
- 2- Fatmir Backaj shtetas shqipetar i dt 1957 lindur dhe banues ne Fier ne adresen lagja "Kryengritja e Fierit"

Personat fizite te mesiperem qe ketu e me poshte ne kete akt-the melues te quajtur bashkarisht ose vecmas ortake kane rene dakort si me po shte:

N e n i 1 EMRI ? QENDRA DHE AFATI I SHOQERISE

Ortaket me marreveshje unanime midis tyre themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila me poshte do te quhet "ALSTEZO SH.P.K .Percaktimet e hollesishme ne lidhje me qellimin dhe me objektin e veprimtarise se shoqerise menyren dhe rregullat e funksionimit te saj tregohen me te plota dhe te lidhura me poshte ne kete akt-themelues dhe ne statutin bashkelidhur.

Emertimi i plote i shoqerise do te jete "ALSTEZO

SH.P.K.

Qendra e shoqerise "ALSTEZO do te jete ne qytetin e Fierit lagja "Kryengritja e Fierit"Ndryshimi i qendres se shoqerise brenda territorit te bashkise nuk sjell ndryshime statutore dhe behet me vendim te asamblese se ortakeve.

Shoqeria me vendim te organeve te saj ,mund te themelohet ose anulloje seli sekondare ,filjale ,perfaqsi,dege dhe agjensi te saj si ne Shqiperi ashtu edhe ne shtete te tjera.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise fillon ne ditet e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregetare ne Tirane dhe shkruhet per nje perjudhe per me teper se dhjete vjet.Asamblea e ortakeve mund te vendose mbarimin perpara afatit te aktivitetit te shoqerise.

N e n i 2 NATYRA JURIDIKE DHE TREGETARE E SHOQERISE

Shoqeria eshte person juridik privat i se drejtes shqiptare ,veprimtaria e te cilit rregullohet nga ky statut akti themelues dhe ne pergjithesi nga legjislacioni shqipetar.

Shoqeria pergjigjet kundrejt te treteve vetem me paguesurite e saj dhe ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga vete ortaket. Ortaket pergjigjen per detyrimet e shoqerise dhe peshojne humbjet e saj deri ne kontributin e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

N e n i 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ALSTEZO" SH.P.K eshte i percaktuar ne keto drejtime:

Auto -shkollle per pregatitjen e drejtuesve te mjeteve motorike te kategorive dhe te shkollleve te ndryshme

Servis ,kolaudim , dhe parking ne teritorin e objektit ne bashkepronesi te ortakeve.

N e n i 4 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar ne castin e krijimit te shoqerise eshte mbi derdhjen e kapitalit ne para prane bankes kombetare tregetare dega Fier si dhe mbi kontributet e ortakeve ne natyre.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane neneshkruar ne teresine e tyre nga ortaket dhe jane shlyer krejtesisht ne te holla me modalitetet e pjesemarrjes si vijon.

Albert Zogaj ka derdhur shumen 100.000 shume kjo e barasvlefshme me 75%(shtatedhejeteepese)te kuotavete pjesemarrjes ne shoqeri.

Fatmir Backa ka derdhur dhe ka shlyer shumen prej _____ leke shume kjo e barasvlefshme me 25%(njezetepese) te kuotave te depozituara ne shoqeri.

Kapitali fillestar i shoqerise mund te rritet nepermjet derdhjes dhe kontributit ne te holla ose me ane te perfshirjes ne te vleftes se objekteve apo te pasurive te pluajteshme ose te luajteshme fituara ose qe do te fitohen ne menyra te ndryshme te ligjeshme nga shria.Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te ligjit Nr7638 d te 19.11.1992"Per shoqerite Tregetare"

Ortaket ne marreveshje midis tyre dhe ne perputhje me aktet e shoqerise ,mund te vendosin rritjen ose paksimin e vleftes se kapitalit themeltar Cdo veprim ne lidhje me kapitalin themeltar te shoqer do te behet ne monedhe shqiptare.

Fondet ne te holla te ardhura nga shlyerja e e pjeseve te kapitalit themeltar jane te depozituara ne llogarine bankare te hap ne emer dhe per llogari te shoqerise prane bankes kombetare tregetare dega Vlore

Ne librin e llogarise te shoqerise rregjistrohet kapitali themeltar dhe detgjohet kontributi i derdhur nga sejcili ortak.Rregull qe kane te bejne me transferimin apo me cedimin e pjeseve te kapitalit ne te parashikuara nga neni 11 i statutit te shoqerise.

N e n i 5 Personaliteti juridik

Shoqeria do te kete zotesi te fitoje te drejta dhe te persiper detyrime qe nga casti i regjistrimit te saj sipas form litet te parashikuara me ligj ne regjistrin e Gjykates se rrethit Tirane.

Shoqeria do te filloje prmtarise sipas objek

ktit te ssaj pas perfundimit te formaliteteve sipas ligjes me organin tat
mor kompetent dhe me organet kompetente per dhenjen e autorizimeve te du-
hura per ushtrimin e atyre veprimtarive.

N e n i 6 Viti financiar

Viti financiar (Ushtrimori) i shoqerise fillon ne 1 (n)
Janar dhe mbaron ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Viti i pare fi-
nanciar do te mbyllet ne 31 Dhjetor te vitit 1995.

N e n i 7 Fitimi i shoqerise

Destinacioni i fitimit neto te shoqerise mbas detyri-
ve fiskale te zbrituara dhe te tjera ne perputhje me ligjin percaktohet me
vendim te asamblese se ortakeve.

N e n i 8 Detyrimet e ortakeve themelues.

Ortaket themelues delegojne administratorin e vetem
te ndjeke kujdeset dhe te permbushe te gjitha veprimet dhe aktet e nevojje-
me per themelimin e shoqerise dhe gjithashtu te permbushe te gjitha forma-
litetet e duhura per per themelin e statutit dhe te aktitit te themelin
si dhe te gjitha veprimet e tjera per njohjen dhe fillimin e aktivitetit
te shoqerise.

Administaratori i vetem eshte i autorizuar te terheq
edhe shumen e derdhur si kapital fillestar mbas regjistrimin e shoqerise
ne regjistrin e shoqerive tregetare ne G jykaten e Tiranes.

N e n i 9 Organet e shoqerise

Organet e shoqerise jane:

1-Asambleja e ortakeve.

2-Administratori i vetem.

Administratori i vetem i shoqerise "ALSTEZO" do te jet njeri prej ortake-
ve te saj Z. Albert Zogaj.

Perberja e funksionet dhe kohezgjatja e organeve te
shoqerise percaktohen ne statutin e saj bashkelidhur dhe ne pjeset perber-
se te ketij akti themelues.

N e n i 10 Fshehtesia e informacionit


Ortaket marrin persiper qe te ruajne reciprokisht
karakterin konfidencial te dokumentacionit ,te informacionit, te te dhen-
ve dhe te pervojës se fituar gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe te
marrin masa te nevojeshme per te penguar perhapjen e tyre ne çfardo meny-
dhe forme.

Ortaket pergjigjen per pasojat e demeshme te shkakt-
ara shoqerise nga mosrespektimi i detyrimeve te lartpermendura.

N e n i 11 Mosmarreveshjet

Ne rastin kur do te lindin mosmarreveshje midis ort-
keve ose midis ortakeve dhe shoqerise lidhur me interpretimin ose me zbat-
imin e ketij akti themelues ortaket deklarojne se i besojne zgjidhjen e

16.02.1996



me mosmarreveshjes nje kolegji ekspertesh te cilet si arbitra do te vendosin per zgjidhjen e asaj mosmarreveshje. Ekspertet do te zgjidhen midis profesionisteve te dhomes se avokateve te rrethit Fier. Ne rast se nuk arrihet dakort i tretme merohet nga kryetari i dhomes se avokateve te rrethit Fier.

Kolegji i eksperteve duhet te dorezoje vendimin e zgjidhjes se mosmarreveshjes brenda tridhjete diteve nga emerimi i tyre. Vendimi merret me shumice votash dhe pa formalitete te vecanta. Ky vendim eshte i detyrueshem per palet dhe ne rast se eshte i nevojshem i paraqitet gjykates se rrethit Tirane.

N e n i 12 Statusi i aktit themelues dhe i statutit te shoqerise.

Shoqeria deklarohet e themeluar dhe veprimtaria saj e rregulluar ne perputhje me dispozitat e ketij akti themelues dhe te statutit te shoqerise dhe kur iceto te fundit jane ne perputhje me legjisllacionin shqiptar.

N e n i 13 Shpezimet e themelimit te shoqerise.

Shpezimet per hartimin dhe per neneshkrimin e ketij akti themelues ashtu edhe per cdo shpezim per njohje ligjore dhe per regjistrimin e shoqerise jane ne ngarkim te kesaj te fundit.

N e n i 14 Dispozite e fundit

Ky akt themelues u hartua ne kater kopje orgjnale kater faqe ne gjuhen shqipe. Shoqeria mban nje orgjinal, ndersa te tjerat depozitohen ne gjykatën e rrethit Tirane, ne zyren e noterise dhe ne organet e sistemit fiskal.

Ortaket pasi e lexuan e kuptuan dhe e pranuan ketij akt themelues e neneshkruan ate. Qe nga ky cast akti i themelimit eshte i detyrueshem per ta.

O R T A K E T E S H O Q E R I S E

ALBERT ZOGAJ FATMIR BACKA

Fier me dt 31/10/1995

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE FIER

Nr. 5364 i regj

Nr. i kol

Minella Nela

V E R T E T I M

Ne Fier sot me daten 31/10/1995 para meje Note:

Minella Nela u paraqiten zoterinjte Albert Zoga dhe Fatmir Backa, shqiptas shqiptare, lindur dhe banues ne Fier per identitetin e te cileve u sigurua ne baze te leternjoftimit te paraqitur, madhor me zotesi te plote te vepruar, te cilet kerkuan konfirmimin e aktit themelues te SH.P.K "ALBERT ZOGAJ". Aktin e themelimit pasi e lexuan e kuptuan dhe e pranuan e konfirmuan ne prezenc en time



NOTERI
Minella Nela

S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SH.P.K)

" A L S T E Z O "

Shoqeria tregtare "ALSTEZO"(SH.P.K)eshte e themeluar ne baze t
aktit themelues te neneshkruar nga themeluesit e saj Albert Zogaj dhe Fa-
tmir Backaj te cilet quhen bashkarisht ose vecmas ortake.

Ortaket jane marre vesh qe pervec sa eshte percaktuar ne aktin
themelues e percaktojne rregullimin e marredhenjeve te tyre dhe te veprimta
rise se shoqerise edhe nepermjet ketij statuti te shoqerise me pergjegjesi
te kufizuar me emertimin "ALSTEZO" SH.P.K.

T I T U L L I 1

EMERTIMI-VULA-QENDRA-KOHEZGJATJA-OBJEKTI

N e n i 1 Shoqeria do te kete emertimin "ALSTEZO" SH.P.K"

N E n i 2 Vula dhe publikimet e shoqerise .

Shoqeria ka vulen e saj,permabajtja e saj do te jete si vijon
"ALSTEZO SH.P.K" Fier Albania.

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe do te nxjerre shoqeria drejtu
ar te tretteve ose publikut si letra, fatura, lajmerime dhe publikime te ndry
shmeduhet te tregojne qarte dhe lexueshem emertimine shoqerise dhe pas tij
fjalet shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ose SH.P.K si dhe kapitalin e saj
dhe emerine e administratorit te shoqerise.

N e n i 3 Qendra e shoqerise, vendbanimi i ortakeve.

Qendra e shoqerise ndodhet ne Fier ne lagjen "Kryengritja e Fi-
erit". Nryshimi i qendres se shoqerise nuk sjell ndryshimin ose modifikimin
e statutit ne qofte se eshte brenda teritorit te bashkise ,por behet me ve-
ndim te asamblese se ortakeve.


Shoqeria me vendim te asamblese se ortakeve ose te administrato-
rit te shoqerise mund te themeloje, transferoje ose anulloje seli dytesore,
seli administrative, filjale, agjensi, dege, perfaqsi, dhe zyra edhe ne lokalite-
te te tjera, si ne teritorin e Shqiperise ashtu edhe jashte saj. Vendbanimi
ose vendndodhja e shoqerise nenekuptohet qe te jete zgjedhur ajo e sejcilit
ortak.

N e n i 4 Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise fillon ne ditën e regjistrimit te saj ne
regjistrin tregetar dhe aktiviteti i saj do te vazhdoje per nje perjudhe ko-
he per me shume se dhjete vjet.

N e n i 5 Objekti i veprimtarise se shoqerise.

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar



"ALSTEZO sh.p.k" eshte i percaktuar ne keto drejtime

-Autoshkolle per pergatitjen e drejtuesve te automjeteve te kategorive te ndryshme.

-Servis, kolaudim, dhe parking per automjete ne teritorin e "Sh.P." ne bashkepronesi te ortakeve.

N e n i 6 Pergjegjesi e shoqerise

Shoqeria pergjigjet kundrejt te treteve veten me pasirine e saj dhe ne asnje rast ajo nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga ortakët dhe as keta te fundit nuk perballojne detyrimet dhe humbjet e shoqerise pertej kufirit te kuotes se tyre ne pjesemarrjen ne kapitalin themelor te saj.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptardhe ana-jelltas.

N E n i 7 E drejta per informacion

Sejcili prej ortakëve ka te drejte te kerkoje dhe te marre informacion prane organeve kompetente te shoqerise lidhur me ecurine e veprimtarise, administrimin dhe gjendjen e financave te saj.

N e n i 8 Cilesia e ortakut, humbja e tij

Cilesia e ortakut vetkupton konsiderimin e qendres se shoqerisesi adrese dhe vendndodhje te ortakut, si dhe pranimin pa asnje kusht te te dijet pozitive te aktit themelues, te statutit te vendimeve te asamblese se ortakëve edhe sikur dispozita te tilla te kene hyre ne fuqi perpara fitimit te cilisise se ortakut.

Cilesia e ortakut humbet kur ai deklarohet i padenje. Me padenjes do te kuptohet veprime konkurruese dhe te pasinjqerta te ortakut kundrejt shoqerise si dhe perhapja nga ana e tij e te dhenave prone e shoqerise dhe te paautorizuara per publikun. Njoftimi i deklarimit si i padenje i behet ortakut nga asamblea e ortakëve me leter rekomande me lajmerim marrje, qe ne te vendoset edhe afati brenda te cilit paraqiten justifikimet.

Ne rast humbje te kuotave te ortakut keto kuota do tu kalojne ortakëve te tjere ne propocion me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin fillestar dhe ne keto raporte do ti derdhen ortakut qe ka humbur cilesine e tille

T I T U L L I 2

Kapitali themeltar, Trasferimi i pjeseve te tij.

N e n i 9 Kapitali Themeltar i shoqerise eshte ne castin e theme limit ne vleren 100.000 leke sipas certifikates bankare qe tregon derdhjen e tyre ne banken kombetare tregetare dhe sipas kontributeve ne tyre, Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane neshkruar ne teresine e tyre nga ortakët dhe jane shlyer ne te holla me modalitetet e pjesemarrje te percaktuara ne aktin e theme limit, ku ortakët zoterojne respektivisht Albert Zogaj 75 % (shtatedhjeepese) dhe Fahir Backaj 25 % (njezetepese) Kapitali fillestar i shoqerise mund te rritet nepermjet neneshkrimit dhe te derdhjes se kontributeve ne te holla, ose me ane te perfshirjes

ne te ,te vleftes se objekteve apo te pasurive te paluajteshme ose te luajteshme te fituara ose qe do te fitohen ne menyra te ndryshme te ligjeshme nga shoqeria.Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te Ligjit 7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare"

Ortaket ne marreveshje midis tyre dhe ne perputhje me aktet e Shoqerise mund te vendosin rritjen ose paksimin e vleftes se kapitalit themeltar

Cdo veprim lidhur me kapitalin fillestar do te behet me monedhe shqiptare

Fondet ne te holla te ardhura nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar jane depozituar ne llogarine bankare, te hapur ne emer dhe per llogari te shoqerise,prane bankes kombetare tregetare Fier.

Ne librin e llogarive te shoqerise rregjistrohet kapitali themeltar dhe detyjohet kontributi i derdhur nga sejcili ortak.

Ne rast se shoqeria do te financohet ,te gjitha ortakët marrin pjesë ne ate financim ne propocion me kuoten e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar

N e n i 10 Zmadhimi i kapitalit

Ne te gjitha rastet e zmadhimit te kapitalit themeltar te vendosur nga asambleja e ortakeve ,ortaket duhet te ushtrojne te drejten e neneshkrimit te kuotave te reja brenda tridhjetë diteve nga data e marrjes se keti vendimi,ose nga data e njoftimit per ortakët qe nuk jane te pranishem ne marrjen e vendimit.

Ne rast te mosneneshkrimit dhe te mosderdhjes se kuotave keto kuota do te shperndahen midis ortakeve te te tjere ne propocion me kuoten e tyre te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar egzistues.

N e n i 11 E drejta e parablerjes dhe cedimi ose transferimi i kuotave

Kuotat e pjesemarrjes ne shoqeri jane personale dhe te transferueshme. Trashegimtaret e ortakut te vdekur zvendesojne pa kushte fizike ne te drejta trashegimtarin e tyre te vdekur.

Ne rast te cedimit te kuotave nga ana e nje ortakut ceduesi ka si detyrim te njoftoje ortakët e tjere ne menyre qe ata te shfrytezoje te drejten e parablerjes.Ne oferten e cedimit ortakut cedues duhet tu beje te qarte ortakeve te tjere vleren e cedimit dhe emrin e bleresit.

Ortakët duhet te ushtrojne te drejten e parablejes per te fituar ate kuota ose te njoftojne vullnetin e tyre se heqin dore nga blerja e tyre brenda tridhjetë diteve nga njoftimi si me siper.Ne rast te ushtrimit te te drejtes se parablerjes ortakët i blejne kuotat qe cedohen ne propocion te pjesemarrjes se tyre ne shoqeri.

Ne rast se cmimi i kerkuar per cedimin e kuotave konsiderohet jo i drejte dhe i teperuar nga ortakët e tjere keta te fundit duhet ta kundërshtojne ate vrere shitje brenda tridhjetë diteve, nga njoftimi dhe cmimi do

te percaktohet nga nje ekspert ne baze te rezultave te arritura ne bilan
e fundit te miratuar.

Cedimet e kryera te treteve pa respektuar kriteret e treguara me s
per ne kete nen ose me nje cmim me te ulet nga ai i kerkuar nga ceduesi
ortakeve ,jane te pavlefshme (nul) dhe nuk do te sjellin pasoja ndaj ort
keve te tjere dhe shoqerise, vec kesaj ortaket do tju linde e drejta per
te brere keto kuota nen ate qe e kerkon personi i trete ose te tretet

N e n i 12 Operacionet financiare

Shoqeri ka te drejten e kerkimit dhe te pranimit te burimeve te fin
ncimit apo te kredive ,hua e tje.duke ju drejtuar bankave dhe instituteve
financiare qe.gezojne te drejten e financimit dhe te kreditimit.

N e n i 13 Blerjet e shoqerise

Shoqeria disponon dhe gezon pasurine e saj ne perputhje me qellimin
dhe me objektin e veprimtarise se saj

Shoqeria ka te drejten e blerjes dhe te administrimit te pasurive t
cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e
saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.

T I T U L L I 3

Financat e shoqerise Bilanci i saj

N e n i 14 Bilanci dhe fondet e shoqerise.

Shoqeria per zhvillimin e aktivitetit te saj,krijon fondet e nevoj
me si dhe fondin rezerve dhe fondet ne zhvillim.Perberja,madhesia e tyre,
burimet e krijimit perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante ne per
thje ne rrethanat ,interesat dhe objektin e veprimtarise vendosen nga asar
blea e ortakeve dhe nga administratori i vetem i shoqerise duke respektuar
dispozitat perkatese ne fuqi.

Shoqeria disponon mjetet e saj financiare.Te gjitha detyrimet e mur
eshme gjate veprimtarise se shoqerise do te perballohen nga fondet per
apo nga fondet rezerve.Te gjitha pasurite e shoqerise pasqyrohen ne bilan
cin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.

Bilanci dhe llogarite e shoqerise perpilohen nga administratori i v
tem sipas modaliteteve mbi bilancin dhe kontabilitetin e shoqerive tregeta
bazuar ne legjislacionin ne fuqi,

Viti financiar (ushtrimori) fillon ne daten 1 Janar dhe mbaron ne d
ten 31 Dhetor te vitit kalendarik.

Bilanci vjetor zyretar detyrimisht i paraqitet asamblese se ortake
brenda tre muajve nga data e mbarimit te cdo viti financiar.

Ne perfundim te cdo viti financiar ,Administratori i vetem merr ma
sat e duhura per pergatitjen dhe per perfundimin e bilacit te shoqerise.,b
zuar ne kriteret te perzgjedhura me kujdesin maksimal duke respektuar dispo
zitat ligjore mbi bilancin dhekontabilitetin e shoqerive tregetare.

Bilancit te shoqerise i bashkelidhet edhe nje relacion shoqerimes pe
veprimtarine e ushtruar nga shoqeria gjate vitit financiar.

Bilanci dhe relacioni i veprimtarise se shoqerise i paraqiten permira tim asamblese se ortakeve.

N e n i 15 Shperndarja e fitimit.

Fitimi neto ,pas zbritjes se shumave te detyruara per pagimin e tatime ve ,taksave dhe te detyrimeve te tjera ligjore ,te shumave per celjen e fondeve te rezerves dhe te fond eve te tjera te nevojeshme do te shpernda hen midis ortakeve ne propocion me kuotat e rezervuara ,pervec marreve- shjes se kundert te arritur ne asamblene e ortakeve.

T I T U L L I 4

Asamblea e ortakeve - Administrimi i shoqerise

N e n i 16 Asamblea e ortakeve.

Asamblea e ortakeve perfshin teresine e ortakeve dhe vendimet e saj te marra ne perputhje me ligjin ,me aktin themelues dhe me kete statut me a- nen e te cilit detyrojne te gjithë ortaket dhe ne mungese ose ne rast men dimi te kundert.Per kryerjen e veprimeve pergatitore, te konsultimeve me shkrim midis ortakeve,thirrjen dhe realizimin e suksesshem te mbeledhjeve te asamblese se ortakeve kujdesi per ecurine e tyre barra bie mbi adminis- ratorin vetem.

N e n i 17 Kompetenca te zakoneshme dhe te jashtezakoneshme.

Asamblea e ortakeve vendos ne menyre te vecante:

- 1-Per miratimin e bilancit vjetor dhe te programit te veprimtarise se shoqerise per vitin e ardheshem.
- 2-Per emrimin e administratorit te vetem.
- 3-Per ndarjen e fitimit midis ortakeve.
- 4-Per ndryshimin e dispozitave te statutit dhe te aktit themelues.
- 5-Per zmadhimin dhe zvigelimin e kapitalit fillestar te shoqerise.
- 6-Per zgjatjen e aktivitetit ose per prishjen e parakoheshme te shoqe- rise.
- 7-Per emertimin e likujdvesve dhe per percaktimin e kompetencave dhe e te drejtave te tyre.

N e n i 18 Mbeledhja e asamblese se ortakeve.

Asamblea e ortakeve mblidhet se paku nje here ne vit te qenderen e sho- qerise apo kudo qofte.Kjo mbeledhje duhet te behet jo me von se nje vit nga mbyllja e vitit financiar, mbas njoftimit me shkrim qe i behet sejcil nga ortaket jo me von se 15 dite nga data kur do te zhvillohet mbeledhja.

Ceshjet qe nuk tregohen ne rendin e dites nuk mund te shqyrtohen perve se me marreveshje unanime ose me tre te katertat e votave te ortakeve.

Mbeledhja e asamblese se ortakeve drejtohet nga ana e administratorit te vetem, dhene rast mungese te tij nga nje person i emeruar prej tij, o- kur nuk eshte as kjo mundesi nga njeri prej ortakeve te zgjedhur me votim nga te pranishmit.Per mbeledhjet e asamblese se ortakeve mbahet proces ve- rbal i cili konfirmohet nga kryetari i asamblese se ortakeve dhe nga sek- retari i saj .Ne raste te vecanta ky proces verbal mund te konfirmohet edhe nga nje noter i zgjedhur nga kryetari i asamblese se ortakeve.

N e n i 19 Vlefshmeri , diskutimi , votimi.

Asamblea e ortakeve eshte e vlefshme ne mbeledhjen e pare ne qofte jane te pranishem ortaket qe perfaqsojne me shume se gjyqsmen e kapitalit themelor te shoqerise.

Vendimet e asamblese se ortakeve merren me shumice absolute te votave te ortakeve qe perfaqsojne me shume se gjysmen e kapitalit fillestar. Përshtimisht lidhur me kompetencat e asamblese se ortakeve te treguara me sipër ne pikat 4,5,6,7 te nenit 17 kerkohet votimi unanim i kapitalit te shoqerise.

Te drejten e votes e kane ortaket qe jane regjistruar ne librin e ortakeve se paku pese dite para mbeledhjes se ortakeve.

N e n i 20 Mbeledhja e asamblese se ortakeve eshte e vlefshme pa u respektuar formalitetet e thirrjes te treguara me sipër ne kete statut atehere kur do te jete i perfaqsuar i gjithe kapitali themeltar i shoqerise.

Vendimet e asamblese se ortakeve jane te detyrueshme si per shoqerine ashtu edhe percilin do ortak i pranishem ose jo ne ate mbeledhje.

N e n i 21 Administrimi i shoqerise

Administrimi i shoqerise behet nga administratori i vetem i saj i zgjedhur nga ana e asamblese se ortakeve nepermjet ortakeve ose jo ortake.

Emertimi i administratorit te vetem behet nga ana e asamblese se ortakeve, pervec emrimit te pare qe do te behet ne aktin themelues per nje perjohje dhe kohe nje vjecare.

Administratori i vetem qendron ne kete funksion per nje perjohje qe Asamblea e Ortakeve e percakton ne aktin e emrimit ,pervec rasteve te doreve te tjera ose te revokimit ne cdo kohe nga ajo asamble.

N e n i 22 Kompetenca te administratorit te vetem.

Administratori i vetem kujdeset dhe vepron me fuge dhe kompetencat me te gjera lidhur ne drejtimin e shoqerise dhe ne menyre me te posacme ka te drejttat e zbatimit dhe te realizimit te qellimeve dhe te objektivave te shoqerise me perjashtim te atyre qe ne baze te ligjit me aktin e themelimit ose me statut i takojne ne menyre taksative dhe ekskluzive asamblese se ortakeve.

N e n i 23 Kompetencat e administrimit

Administratorit te vetem i takojne ne menyre te vecante kompetencat qe vijojne:

- 1-Te vere ne zbatim vendimet e asamblese se ortakeve.
- 2-Te organizoje dhe te racionalizojte punen per permbushjen e objektivave te shoqerise, duke relatuar ne asamblene e ortakeve.
- 3-Te administroje pasurine dhe mjetet e shoqerise, perfshire mjetet financiare ne perputhje me dispozitat e statutit aktin themelues, vendimet e asamblese se ortakeve dhe me dispozitat ligjore.
- 4-Te drejtoje dhe te kontrolloje veprimtarine e filjaleve, agjnesive, perfaqesive, zyrave dhe te tjera si keto te krijuara nga shoqeria.

5- Te lidhe kontrata të cfarëdo lloji e natyre në emer dhe për llogari të shoqërisë.

6-Te bëjë çdo pagesë që detyrohet shoqëria ,te marrë dhe të pushojë nga puna personelin e shoqërisë dhe të nënshkruajë kontratat përkatëse.

Administratori i vetëm është përgjegjës ndaj shoqërisë për detyrimet që janë brenda kompetencës së tij ekskluzive.

N e n i 24 Perfaqsimi dhe firma e shoqërisë

Te drejten e firmës përpara subjekteve shtetërore apo private ,vendas apo të huaj si dhe përpara gjykatësve e ka administratori i shoqërisë .Administratori i vetëm ka të drejtë që të delegojë duke emëruar prokurues të ndryshëm të posaçëm,dhe kufizohet nga e drejta për prokurues me prokurë të përgjithëshme.

N e n i 25 Kontrolli ekonomik-financiar.

Për kontrollin e aktivitetit të shoqërisë ,filjaleve dhe të agjensive asamblea e ortakëve emëron një ose disa eksperte kontabel të autorizuar.Këta eksperte kontabel emërohen për çdo vit ushtrimor ,jane të riemërueshëm dhe nuk duhet të jenë punonjës të shoqërisë,filjaleve të saj agjensive,perfaqësive apo të degeve të saj.

N e n i 26 Marrëdhënjet e punës.

Marrëdhënjet e punës nëpërmjet shoqërisë ,filjaleve , agjensive dhe të punonjësve të tyre rregullohen nëpërmjet kontratave të punës.Për çështjet që nuk parashikohen në kontratën e punës zbatohen dispozitat e legjisllacionit shqiptar në fuqi apo të vendit ku ndodhet filjali agjensia,perfaqësia.

T I T U L L I 5

Mbarimi, prishja , likuidimi.

N e n i 27 Prishja e shoqërisë.

Shoqëria priset në rastet kur:

- 1-Mbaron afati i parashikuar në aktin themelues.
- 2-Nuk realizohet objekti i shoqërisë sipas aktit themelues dhe statutit.
- 3-Merret vendim nga asamblea e ortakëve.
- 4-Në rastet e parashikuara në ligj.

N e n i 28 Likuidimi i shoqërisë.

Në rast të prishjes së shoqërisë në çfarëdo lloj kohe dhe për çfarëdo lloj arsye asamblea e ortakëve emëron një ose disa likuidatorë.Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave të legjisllacionit falimentar shqiptar në fuqi në castin e likuidimit.

Asamblea e ortakëve vendos rregullat për procedurën e likuidimit për personat që do të aplikojnë ato,për shpërblimin dhe kompetencat e tyre.

Ne përfundim të procedurave të likuidimit pasuria net

shoqerise do te shperndahet midis ortakeve ne perputhje me kuoten respektive te pjesemarrjes ne kapitqilin themeltar.

N e n i 29 Mbarimi i filjaleve.

Mbarimi i veprimtarise se filjaleve ,perfasisive dhe agjensive e te tjera vendoset nga asamblea e ortakeve. Likujdimi i tyre kur jane vendosur jashte shtetit rregullohet nga legjislacioni i shtetit ne te cilin jane vendosur.

T I T U L L I 6

Dispozitat e fundit

N e n i 30 Mosmarreveshjet

Ne rastin kur do te lindim mosmarreveshje midis ortakeve ose ortakeve dhe shoqerise lidhur me interpretimin ose me zbatimin ketij statuti ortaket deklarojne se i besojne zgjidhjen e mosmarreveshjes nje grupi te eksperteve te cilet si arbitra do te zgjidhin mosmarreveshjen.

Ekspertet do te zgjidhen midis profesionisteve te listes se dhomes se avokateve te rrethit Fier. Sejcila pale emerone nje ekspert, ndersa i treti caktohet midis dy eeksperteve te emeruar, pra zgjidhet prej tyre. Kur mungon ky vullnet ky i fundit emerohet nga kryetari i dhomes se avokateve te rrethit te Fierit me kerkesen e njeres pale.

Kolegji i eksperteve do te dorezoje vendimin per zgjidhjen e mosmarreveshjes brenda 30 diteve nga emerimi i tyre. Vendimi merr me shumice te votave dhe pa formalitetet e vecanta. Ky vendim eshte i detyrueshem per palete dhe zbatimi i tij i paraqitet gjykates se rrethit Tirane.

N e n i 31 Dispozita te zbatueshme per shoqerine

Marredhenjet ne shoqeri rregullohen me dispozitat e aktit themelues, statutit, vendimet e asamblese se ortakeve dhe te administratoritme kusht qe te jene ne perputhje me ligjin. Per marredhenjet dhe problemet qe nuk jane te trajtuara shprehimisht ne aktet e mesiperme do te zbatohen dispozitat e akteve ligjore dhe nenligjore te fushes tregtare dhe ne pergjithesi te legjislacinit shqipeter.

N e n i 32 Dispozitat e fundit.

Ky statut hyn ne fuqi dite ne regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar ne gjykaten e rrethit Tirane. Ky statut u hartua ne gjuhen shqipe ne kater kopje orgjinale. Shoqeria mban nje orgjir dhe me kopje te tjera dergohen ne Gjykaten e rrethit Tirane ,ne zyren e noterise si dhe ne organet e sistemit fiskal.

Ortaket pasi u njohen me permbajtjen e ketij statuti e pranuan ate dhe e neneshkruan ate sot me daten _____ 1995

O R T A K E T E S H O Q E R I S E

ALBERT ZOGAJ

FATMIR BAKAJ